



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT BUJAR DELIALLISI

Nr. 40, datë 29.08.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Edona Dushaj	Kryesuese
Enton Radovani	Relator
Kleada Mersinllari	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Erlisa Kalaja, në datën 29.08.2024 ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Bujar Masar Deliallisi, me funksion aktual Zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore Policisë, Durrës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

OBJEKTI:

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e **relatorit të çështjes z. Enton Radovani**; dëgjoi subjektin e vlerësimit, z. **Bujar Deliallisi**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 25.07.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Zëvendës drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, Durrës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi z. Bujar Deliallisi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023 si “Zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës”.
3. Subjekti i vlerësimit, z. **Bujar M. Deliallisi**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar me datë 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin e datës 26.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Enton Radovani, **Relator**, znj. Edona Dushaj, **Kryesues**, dhe znj. Kleada Mersinllari, **Anëtar**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr.74/1, datë 26.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi.
6. **Relatori i çështjes**, z. Enton Radovani, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar nr. 74/5 prot., datë 28.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 01.08.2023 e cila është protokolluar me nr. 74/6, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
11. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
 - e. Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
 - g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”
 - h. duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:
 - ✚ *Deklarata e Pasurisë,*
 - ✚ *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
 - ✚ *Formulari i Vlerësimit Profesional*
 - ✚ *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*
 - i. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
 - k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
 - l. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

12. Trupa e vlerësimit, me datë 17.07.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi, me Vendimin nr. 4, datë 17.07.2024, vendosi;
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi,
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraparak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
13. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
14. Në datën 18.07.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 25.07.2024, ora 10:00, në ambiente të Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë.

Në fund të seancës dëgjimore të datës 25.07.2023, subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

15. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
16. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **z. Bujar Deliallisi** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. 8 index, viti 2023.
17. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
18. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
19. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
20. **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
 - ✚ deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
 - ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
 - ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
 - ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaramet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;
21. **Hetimi administrativ konsistoi në:**
 - ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
 - ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
 - ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
 - ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit;

A. DEKLARIMI I PASURIVE

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi, ku është konstatuar se:

- ✓ **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- ✓ **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- ✓ **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

23. Bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklarinet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklarinet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (I) verifikimin e vërtetësisë së deklarinave në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (II) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (III) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi

¹ Raporti nr. 46/53, datë 28.02.2023, i ILDKPKI-së.

ose në përdorim; (IV) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

- ✚ Apartament banimi² me nr. pasurie ***, zk. ***, me sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 150.53 m², verandë 23.4 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 21 m², në adresën Lagjja nr. ***, Rruga ***, Pallati ***, Durrës.
Vlera: 70 000 euro. Zotëron 50% dhe 50% zotërohet nga bashkëshortja.

Apartamenti përbehet nga dy prona të bashkuara në një të vetme.

- **Prona e parë:** me sipërfaqe 105 m² (bashkë me hapësirat e përbashkëta), blerë në datën 15.07.2011, me vlerë 70 000 euro.

Burimi i krijimit: Nga kursimet familjare.

- **Prona e dytë:** me sipërfaqe totale 90.1 m², nga të cilat, sipërfaqe e apartamentit 55.7 m², sipërfaqe verande 23.4 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 11 m², e likuiduar në datën 25.02.2021.

Burimi i krijimit: huaja e marrë nga motra e bashkëshortes, shtetasja D.Xh.

- Të dyja pasuritë janë regjistruar në një të vetme në vitin 2021, me nxjerrjen e certifikatës së regjistrimit të pronësisë, pas legalizimit të objektit.

25. Subjekti sqaron në lidhje me burimi i krijimit nr. 1:

Apartament 2+1, me sipërfaqe 105 m², marrë me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2011, me adresë: Lagjja nr. ***, Shëtitorja ***, Durrës, me vlerë *** euro, i blerë me kontributin e të gjithë pjesëtareve të familjes sime (në atë kohë isha i pamartuar dhe jetoja me prindërit dhe motrën).

Përveç të ardhurave nga pagat familjare, pjesa më e madhe e shumës për blerjen e apartamentit është siguruar ndër vite, si vijon:

- Shuma 1.200.000 lekë: Të ardhura nga shitje e aksioneve në Parkun e Mallrave Durrës, në emër të babait tim M.D. (Nuk gjendet dokumentacion. Vërtetuar nga RFB, nr. ***, prill 2023).
- Shuma 10.755 USD: Transfertë nga SHBA në emër të nënës time Sh. Deliallisi, nga i vëllai ****, në vitin 2011. (sipas dokumentit nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank datë 12.04.2018).
- Shuma 42.325 USD: Të ardhura të familjes sime nga ndihma ndër vite prej familjarëve të nënës sime Sh. D., të cilët jetojnë prej vitit 1945 në SHBA. Kjo shumë është

² Kjo pasuri është e përbërë nga dy pjesë.

depozituar në llogari bankare në Raiffeisen Bank, plus 4.000 USD interesa bankare, në emër të motrës sime, *** dhe më pas është tërhequr dhe është përdorur për blerjen e apartamentit (sipas dokumentit “nxjerrje llogarie” datë 12.4.2018). Vërtetuar me Deklaratë Noteriale datë 23.4.2018, të shtetasve amerikanë *** dhe *** (dajat e mi).

- **Shuma 1.856.388 lekë:** Të ardhura nga pensioni i gjyshes *** (nëna e nënës), e cila ka jetuar në SHBA nga viti 1994 - 2012. Pensioni i gjyshes është tërhequr dhe përfituar nga nëna ime, ****, sipas prokurës nr. ***, datë 22.03.1994 dhe prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.4.2003. Vërtetuar me vërtetimin nr. *** prot., datë 16.4.2018 dhe konfirmim tërheqje pensioni nr. *** prot., datë 25.04.2018. vërtetuar me deklaratë noteriale datë 23.04.2018, të shtetasve amerikanë *** dhe *** (dajat e mi).
- **Shuma 2.000.000 lekë:** Kursime nga të ardhurat e mia ndër vite (2000 -2011).
- **Shuma 525.000 lekë:** Të ardhura nga pensioni i dajës ***, për periudhën 2009 - korrik 2011 si dhe dëmshpërblim për burgim politik (kësti i parë, deri në atë kohë). Kjo shumë është tërhequr dhe përfituar nga nëna ime ****. Vërtetuar me prokurë nr. ***, datë *** dhe konfirmuar me Deklaratë Noteriale datë 23.04.2018, të shtetasve amerikanë *** dhe **** (dajat e mi).
- **Shuma 304.205 lekë:** Letra me vlerë, përfituar nga nëna ime ***, sipas urdhër xhirimit me nr. 009433, datë 21.02.1995.

26. Subjekti sqaron në lidhje me burimi i krijimit nr. 2:

- Apartamenti me sipërfaqe totale 90.1 m², nga të cilat, sipërfaqe apartamenti 55.7 m², sipërfaqe verande 23.4 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 11 m², e likuiduar në datë 25.02.2021, me vlerë totale 20.000 euro (blerë në karabina).
- Në deklaratën noteriale datë 25.02.2021, shtetasi L.K. më ka premtuar në dhjetor 2018 shitjen e asetit të mësipërm (karabina).
 - a) Në dhjetor 2018 kam paguar shumën 2.000 euro parapagim.
 - b) Në shkurt 2019 kam paguar shumën 3.000 euro.
 - c) Në datën 25.02.2021 është likuiduar plotësisht vlera e mbetur prej 15.000 euro.
- Shuma totale prej 20.000 euro për blerjen e këtij aseti (karabina) është siguruar nga huaja e marrë nga motra e bashkëshortes, shtetasja D.Xh., pa afat dhe pa interes sipas Deklaratës Noteriale nr. *** rep., nr. ***kol., datë 01.09.2018.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shitje nr. 799 rep., nr. 326 kol., datë 26.2.2021**, me blerës Bujar Deliallisi dhe shitës shoqëria “****” shpk, për blerjen e pasurisë nr. ***, zk. ***, e llojit apartament, në katin e parë të banimit, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 150.53 m², verandë 23.4 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 10 m², e ndodhur në Lagjen nr. ***, Rruga ***, Durrës. Vlera 90.000 euro, e likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2011, e shoqëruar me mandate dhe deklaratë noteriale.
- **Certifikatë regjistrimi pronësie lëshuar në datë 12.01.2021**, për pasurinë nr. ***, zk. ***, e llojit apartament, me sipërfaqe 150.53 m², me adresë. '*** Durrës, në pronësi të *** shpk.

- **Kartela e pasurisë nr. ***, ND***, Zk *****, e llojit apartament, me sipërfaqe 150.53 m², me adresë: '***', Durrës, regjistruar në pronësi të *** shpk., datë 12.01.2021.
- **Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2011**, me porositës Bujar Deliallisi dhe sipërmarrës investitor shoqëria “***” shpk, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 105 m², në katin e parë të banimit në objektin godinë banimi dhe shërbim 12 kat mbi tokë + 1 kat nën tokë, me adresë: Lagjja nr. ***, Durrës. Çmimi i shitjes me vlerë 70.000 euro, u likuiduar sot në selinë e *** shpk.
- **Mandat arkëtimi nr. ***, datë 15.07.2011**, lëshuar nga *** shpk, për pagesën e shumës 70 000 euro nga Bujar Deliallisi, për apartamentin nr. 3, me sipërfaqe 105 m².
- **Kontratë sipërmarrje** datë 18.08.2006, me porositës N.K. dhe sipërmarrës shoqëria “***” shpk, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 90.1 m², në katin e parë të banimit që po ndërtohet në Durrës tek Shëtitorja ***. Çmimi i apartamentit është 500 euro/m², në total 38.000 euro.
- **Leje Ndërtimi nr. ***, datë 28.12.2005**.
- **Deklaratë noteriale nr. ***6 rep., nr. *** kol., datë 25.02.2021**, me deklarues Bujar Deliallisi dhe L.K. i cili deklaron se i ka premtuar për shitje, z. Bujar Deliallisi një sipërfaqe të banueshme prej 90.1 m² nga e cila 55.7 m² sip. apartamenti, 23.4 m² sip. verandë dhe 11 m² sip. e përbashkët, ndodhur në katin e parë të banimit në godinën e ndërtuar nga *** shpk me adresë: Lagjja nr. ***, Rruga ***, Durrës. Gjithashtu, L.K., deklaron se këtë apartament ja ka premtuar në dhjetor 2018, për t'ia kaluar në pronësi me vlerë 20.000 euro për shkak se kjo sipërfaqe i është dorëzuar z. Bujar Deliallisi si karabina ku, ky i fundit ka vazhduar punimet personalisht për funksionimin si apartament të sipërfaqes së marrë. Në dhjetor 2018 ka marrë nga blerësi i ardhshëm shumën 2.000 euro dhe në vijim në shkurt 2019 ka marr edhe vlerën 3.000 euro dhe totali prej 5.000 euro përfshihet në çmimin e shitjes së apartamentit. Sot, në datën e kësaj deklarate palët deklarojnë se janë likuiduar plotësisht për vlerën e mbetur prej 15.000 euro të shitblerjes së këtij apartamenti, pa patur pretendime në të ardhmen. Gjithashtu, pas aktit përfundimtar të kolaudit dhe regjistrimit në ASHK Durrës, të lejes së legalizimit përkatëse, apartamenti i blerë nga z. L.K. është brenda sipërfaqes që i përket apartamentit nr. 2, me nr. pasurie *** i cili është përfutur nga bashkimi në natyrë i apartamentit të blerë nga z. Bujar Deliallisi tek shoqëria “***” shpk., sipas kontratës nr. *** rep., nr. 506 kol., datë 15.07.2011 dhe apartamentit të blerë nga z. L.K. si karabina. L.K. deklaron se nuk ka asnjë pretendim dhe është plotësisht dakord që kontrata e tjetërsimit të pasurisë në total të jetë midis shoqërisë “***” shpk dhe z. Bujar Deliallisi.
- **Kthim përgjigje nga Raiffeisen Bank**, drejtuar B. Deliallisi, me nr. *** prot., 04/2023, ku vërtetohet se referuar kërkesës për informacion lidhur me transaksionet e kryera pranë ish-Bankës së Kursimeve për periudhën 1998 - 2001, nuk janë gjetur të dhëna.
- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 12.4.2018, për llogarinë në emër të Sh. Deliallisi, ku rezulton kreditimi me transfertë i shumës 10.754 USD, në datën 25.02.2011, me përshkrimin “..D.P...” dhe debitimi cash i shumës totale rreth 10.755 euro, për periudhën 29.08.201 - 02.09.2011.

- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 12.04.2018 dhe në datën 05.10.2020, për llogarinë në emër të Sh. D., ku rezulton: *kreditimi me transfertë i shumës 3.000.000 lekë, në datën 03.09.2010, me përshkrimin “..Transferim Fondesh, Sh. Deliallisi.. debitimi cash i shumës 3.000.000 lekë, në datën 9.11.2010; si dhe kreditimi i të ardhurave në shumën totale rreth 1.570.000 lekë, për periudhën 01.03.2011 - 10.10.2018”*.
- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 12.04.2018, për llogarinë në emër të E. Deliallisi, ku rezulton kreditimi i shumës 36.315 USD, në datën 02.07.2007, me përshkrimin “*maturim depozite*” dhe debitimi cash i shumës 36.310 USD, në datë 04.07.2007; kreditimi cash i shumës 40.695 USD dhe hapja e depozitës në datën 03.10.2007, kreditimi i shumës 42.351 USD, në datën 03.10.2008, me përshkrimin 'shlyerje depozite ' dhe debitimi cash i shumës 42.345 USD, në datën 06.10.2008, me përshkrimin “*depozitë + interesa*”.
- **Kthim përgjigje nga Posta Shqiptare**, me nr. *** prot., datë 25.04.2018, ku vërtetohet se tërheqja e pensionit të përfituesit S. Q. P. është kryer nga z. M. Deliallisi, sipas prokurës datë 17.04.2003, deri në tërheqjen e fundit në datë 09.10.2012.
- **Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. 204 kol., datë 17.04.2003**, lëshuar nga e përfaqësuar Sh. Q. P., e përfaqësuar për nënshkrim nga vajza e saj, Sh. Deliallisi, për emërimin si përfaqësues të posaçëm z. M. Deliallisi (bashkëshort i vajzës së saj), të cilit i jep të drejtë dhe kompetencë të plotë, që në emër dhe për llogari të saj, të paraqitet pranë organeve kompetente për të tërhequr pensionin e saj.
- **Prokurë e posaçme nr. *** regj., datë 22.03.1994**, lëshuar nga e përfaqësuar Sh. P. për emërimin si përfaqësues të posaçëm znj. Sh. Deliallisi dhe z. M. Deliallisi, të cilëve ju jep të drejtë dhe kompetencë të plotë, që në emër dhe për llogari të saj, të paraqiten bashkë ose veç e veç, pranë Arkës së Sigurimeve Shoqërore - Shëndetësore, për të tërhequr pensionin e saj.
- **Vërtetim nga ISSH, nr. *** prot., datë 16.04.2018**, ku vërtetohet se Sh. P. ka përfituar pension pleqërie nga data 01.10.1991 deri në datën 25.03.2013 (mbyllur dosja e pensionit pasi është ndarë nga jeta në datën 11.10.2012). Totali i të ardhurave të përfituara për periudhën 01.01.1994 - 11.10.2012, është në vlerën 2.117.871 lekë.
- **Deklaratë ***, datë 23.04.2018, me noterizim nënshkrimi** (vulë apostile datë 01.05.2018), me deklarues R. Serri P. dhe D. Serri P.. R. P. deklaroi se, prej muajit prill 1994 i ka lënë motrës së tij Sh. Serri Deliallisi: të përfitojë qiranë e shtëpisë (2+1) që ka patur në pronësi në Fier nga viti 1993 deri në vitin e shitjes 2008; të përfitojë nga të gjitha të ardhurat që burojnë nga një shtëpi, sipërfaqe toke dhe rrënjë ullinjsh, dhënë sipas ligjit nr. 7501 në Frakull e Madhe, Fier; të tërheqë dhe përfitojë pensionin e tij personal që nga dita e parë; të tërheqë dhe përfitojë të gjithë shumën e dhënë shpërblimit të tij si ish i burgosur politik. Deklaroi se e ka ndihmuar ndër vite financiarisht motrën e tij dhe do të vazhdojë ta bëjë në të ardhmen me sa mundësi të ketë. Gjithashtu, deklaroi se, nëna e tij e ndjerë Sh. P., rezidente në SHBA, që nga muaji prill 1994 deri sa ndërroi jetë në datën 11.10.2011, i ka lënë me vullnetin e saj të lirë, të drejtën e tërheqjes dhe përfitimit të pensionit të saj, të bijës, Sh. Deliallisi. D.P. deklaroi se e ka

ndihmuar ndër vite financiarisht motrën e tij dhe do të vazhdojë ta bëjë në të ardhmen me sa mundësi të ketë.

- **Prokurë e përgjithshme nr. *** regj., datë 07.03.1994**, lëshuar nga i përfaqësuari R. P. për emërimin si përfaqësues të posaçëm znj. Sh. Deliallisi dhe z. M. Deliallisi, të cilëve j'u jep të drejtë dhe kompetencë të plotë: të administrojnë pronat e tij të ndodhura në qytetin Fier dhe në Frakull apo dhe ti japin ato me qira si dhe të paraqiten bashkë ose veç e veç, të tërheqin të gjitha të ardhurat që vijnë nga statusi i tij si i përndjekur politik apo shpërblim nga vitet e burgut.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, lëshuar në datën 04.11.2016, për pasurinë nr. ***, vol. 8, faqe ***, zk. ***, e llojit arë, me sipërfaqe 380 m² + truall me sipërfaqe 200 m², nga e cila, ndërtesa me sipërfaqe 48 m², ndodhur në Frakull e Madhe, Fier, regjistruar në pronësi të R. Serri P..
- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, lëshuar në datën 11.03.2016, për pasurinë nr. ***, VOI. **, faqe ***, zk. ***, e llojit arë, me sipërfaqe 4687 m², e ndodhur në Fier, regjistruar në pronësi të R. Serri P..
- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, lëshuar në datën 11.03.2016, për pasurinë nr. ***, VOI. **, faqe ***, zh. ***, e llojit arë, me sipërfaqe 3094 m², e ndodhur në Fier, regjistruar në pronësi të R. Serri P..
- **Certifikatë familjare e vitit 1945-1950**, lëshuar në datën 27.05.2013, me kryefamiljar Serri P., me bashkëshorte Sh. P. dhe fëmijë R. P., D.P. dhe Sh. P..
- **Librezë për pension nr. *****, për shtetasin R. Serri P., lëshuar nga DRSSH Fier, me datë pagese 10.05.2009, me pension mujor në shumën 12.290 lekë.
- **Urdhërshirim nga Banka e Kursimeve (Lajmërim Debitimi) nr. *****, datë 21.02.1995, për shumën 304.205 lekë, me debitor (*shitës*) Sh. Deliallisi dhe kreditor Tofik Hyka.
- **Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.09.2018**, me deklarues debitor Bujar Deliallisi dhe deklarues kreditor D.Xh.. Bujar Deliallisi deklaroi se i detyrohet palës kreditore D.Xh., shumën monetare prej 20.000 euro, të cilën ajo ja ka dhënë në formë borxhi sot në datë 01.09.2018 duke e kredituar në emrin e tij në Raiffeisen Bank dhe këtë shumë monetare do ta kthej me kërkesën e palës kreditore ndaj tij, duke njohur detyrimin dhe marrë përsipër kthimin e shumës. D.Xh. deklaroi se është plotësisht dakord me sa më sipër.

Bashkëlidhur:

- **Mandat depozitimi nga Raiffeisen Bank, datë 01.09.2018**, me urdhërues D.Xh. dhe përfitues Bujar Deliallisi, për shumën 20.000 euro, me përshkrimin “..Hua sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2018.”.
- **Vërtetim mbi produktet bankare nga Raiffeisen Bank, datë 04.04.2023**, ku rezultoi se në llogari të klientit Bujar Deliallisi është kredituar shuma totale 20.000 euro, në vitin 2018 dhe është debituar shuma totale 19.997 euro në vitin 2021.

27. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në llogari të Bujar Deliallisi, rezulton: debitimi me transfertë në favor të Sh. Deliallisi, i shumës 3.000.000 lekë, në datën 3.9.2010.
- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në llogari të Bujar Deliallisi, rezulton: kreditimi i shumës 20.000 euro, në datën 01.09.2018, me përshkrimin “D. B. Xh.”, jep hua sipas deklaratës noteriale nr. 869 rep., nr. 582/2 kol., datë 01.09.2018 “...dhe debitimi cash i shumës 19.987 euro, në datën 23.02.2021...”.
- **ASHK, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresën nr. ***prot., datë 05.10.2023**, konfirmon se në bashkëpronësi të Bujar Deliallisi dhe Oneda Deliallisi, rezulton: pasuria nr. ***, VOL. ***, faqe ***, zk. ***, e llojit apartament.

28. Korrespondenca me institucionet:

- **Kartela e pasurisë nr. ***, ZIC. *****, e Llojit apartament, me sipërfaqe 150.53 1112, me adresë: '***', Durrës, regjistruar në bashkëpronësi të Bujar Deliallisi dhe Oneda Deliallisi në datën 26.2.2021, sipas kontratës së shitjes nr. 799/326, datë 26.2.2021. **Referuar informacioneve për pronën, rezulton: Sipërfaqe verande 23.4 m².**
- **Certifikatë regjistrimi pronësie datë 26.2.2021**, për pasurinë nr. ***, zk. 8512, e llojit apartament, me sipërfaqe 150.53 m², me adresë: Rr. '*** ' Durrës, në bashkëpronësi të Bujar M. Deliallisi me pjesë takuese 1/2.
- **Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.2.2021**, me blerës Bujar Deliallisi dhe shitës shoqëria “***” shpk, për blerjen e pasurisë nr. ***, zk. ***, e llojit apartament, në katin e parë të banimit, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 150.53 m², verandë 23.4 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 10 m², e ndodhur në Lagjen nr. 1, Rruga ***, Durrës. Hera 90.000 euro, e likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2011, e shoqëruar me mandate dhe deklaratë noteriale.
- **Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.7.2011**, me porositet Bujar Deliallisi dhe sipërmarrës investitor shoqëria “***” shpk, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 105 m², në katin e parë të banimit, në objektin godinë banimi dhe shërbim 12 kate mbi tokë + 1 kat nën tokë, me adresë: Lagjja nr. 1, Sh. ***, Durrës. Çmimi i shitjes me vlerë 70.000 euro, u likuidua sot, dt. 15.07.2011, në selinë e “*** shpk”.
- **Mandat arkëtimi nr. ***, datë 15.07.2011**, lëshuar nga *** shpk, për pagesën e shumës 70.000 euro nga Bujar Deliallisi, për apartamentin nr. 3, me sipërfaqe 105 m².
- **Kontratë sipërmarrje datë 18.08.2006**, me porositet L.K. dhe sipërmarrës shoqëria “***” shpk, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 90.1 m², në katin e parë të banimit që po ndërtohet në Durrës tek Shëtitorja ***. Çmimi i apartamentit është 500 euro/m², në total 38.000 euro (likuiduar). Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.02.2021, me deklarues Bujar Deliallisi dhe L.K. i cili deklaroi se i ka premtuar për shitje z. Bujar Deliallisi një sipërfaqe të banueshme prej 90.1 m², nga e cila, 55.7 m² sip. apartamenti, 23.4 m² sipërfaqe verande dhe 11 m² sipërfaqe e përbashkët, ndodhur në katin e parë të banimit në godinën e ndërtuar nga “***” shpk., me adresë: Lagjja nr. ***, Rruga ***, Durrës. Gjithashtu, L.K., deklaroi se këtë apartament ja ka premtuar në dhjetor 2018, për t'ia kaluar në pronësi me vlerë 20.000 euro, për shkak se

kjo sipërfaqe i është dorëzuar z. Bujar Deliallisi si 'karabina', ku, ky i fundit ka vazhduar punimet personalisht për funksionimin si apartament të sipërfaqes së marrë. Në dhjetor 2018 ka marrë nga blerësi i ardhshëm shumën 2.000 euro dhe në vijim, në shkurt 2019 ka marrë edhe vlerën 3.000 euro dhe totali prej 5.000 euro përfshihet në çmimin e shitjes së apartamentit. Sot në datën e kësaj deklarate, pala deklarojnë se janë likuiduar plotësisht për vlerën e mbetur prej 15.000 euro të shitblerjes së këtij apartamenti, pa patur pretendime në të ardhmen. Gjithashtu pas aktit përfundimtar të kolaudimit dhe regjistrimit në ASHK, Durrës, të lejes së legalizimit përkatëse, apartamenti i blerë nga z. L.K. është brenda sipërfaqes që i përket apartamentit nr. 2, me nr. pasurie ***, i cili është përfitur nga bashkimi në natyrë i apartamentit të blerë nga z. Bujar Deliallisi tek shoqëria “****” shpk., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.7.2011 dhe apartamentit të blerë nga z. L.K. si karabina. L.K. deklaron se është plotësisht dakord që kontrata e tjetërsimit të pasurisë në total të jetë midis shoqërisë “****” shpk dhe z. Bujar Deliallisi.

- **ASHK (online). konfirmon pasurinë** nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk***, e ndodhur në Durrës, në bashkëpronësi të Bujar M. Deliallisi dhe Oneda B. Deliallisi, me status “aktive” dhe përshkrim “verandë” 23.4 m².
- **ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2023**, konfirmon se shtetasi M. Deliallisi përfiton pension pleqërie prej muajit shtator 1999, me masë aktuale 29.246 lekë/muaj. Gjithashtu, konfirmon se shtetasja Sh. Deliallisi përfiton pension pleqërie prej muajit mars 2009, me masë aktuale 20.014 lekë/muaj.
- **ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2023**, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
- **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2023, sqaron se për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar n.q.s. nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna.
- **Vërtetim për vjetërsinë në punë** për efekt pensioni, për M. Sh. Deliallisi, i cili rezulton: i punësuar si elektrikist (elektroauto) për periudhën 01.01.1959 - 01. 12.1977; invalid i grupit të dytë për periudhën 01.12.1977 - 31.03.1978; dhe i punësuar si elektroauto për periudhën 01.04.1978 - 10.07.1994.
- **Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni**, për Sh. S. Deliallisi, e cila rezulton: e punësuar si elektriciste për periudhën 12.12.1970 - 01.10.1991.

29. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se sipërfaqja e pasurisë së paluajtshme është deklaruar duke u bazuar në dokumentacion pas bashkimit të dy apartamenteve duke saktësuar se për apartamentin e blerë sipas kontratës së sipërmarrjes datë 15.07.2011, nga sipërfaqja totale prej 105 m², rreth 10 m² janë sipërfaqe e përbashkët për të cilën nuk disponon dokumentacion shtesë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se apartamentin me

sipërfaqe 90.1 m² e ka blerë sipas dokumentacionit të dorëzuar nga L.K., i cili në dijeninë e tij është i njëjti shtetas me N.K., duke saktësuar se vlera e blerjes është rezultat i marrjes në dorëzim të asetit si karabina, pa investime të përfunduara. Lidhur me mobilimin e shtëpisë, subjekti ka sqaruar se janë kryer investime minimale, me vlera për të cilat nuk disponon dokumentacion vërtetues, për shkak të kryerjes së këtyre investimeve pjesë-pjesë me burim financiar nga kursimet dhe të ardhurat ndër vite. Subjekti ka sqaruar se, pasuria e paluajtshme e blerë si karabina është aktualisht e pa përshtatur për banim, pasi është e pa mobiluar plotësisht, duke qenë se e ka blerë me qëllim marrjen e prindërve në të ardhmen. Gjithashtu, ka sqaruar se, deri në qershor 2014, në momentin e hyrjes në shtëpinë e deklaruar, ka banuar së bashku me prindërit dhe motrën në apartamentin 2+1 në pronësi të prindërve M. Deliallisi, Sh. Deliallisi dhe motrës E. Deliallisi, e blerë nga Ndërmarrjes Komonale e Banesave në vitin 1993, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

- Lidhur me shumën 1.200.000 leke, të deklaruar si burim financiar, subjekti sqaroi se paraqet kopje të kërkesës drejtuar Raiffeisen Bank (ish Banka e Kursimeve) duke saktësuar se është në pamundësi objektive të zotërimit të dokumentacionit shtesë. Lidhur me shumën 10.755 USD, subjekti sqaroi se transferata është kryer nga llogaria bankare e dajës D.P., në llogari të nënës së tij Sh. Deliallisi, duke konfirmuar se si burim financiar kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat e dajës. Gjithashtu, subjekti sqaroi se, të dhënat lidhur me të ardhurat e dajës në SHBA janë të verifikueshme sipas sistemit TurboTax prej vitit 2013 dhe në vijim, duke sqaruar se për të dhëna të mëhershme nuk disponohet dokumentacion shtesë, duke paraqitur dokumentacionin e disponuar dhe duke sqaruar se, aktualisht, D.P. ka dalë në pension pasi ka punuar për rreth 30 vite në SHBA.
- Lidhur me shumën 42.325 USD, subjekti sqaroi se kanë si burim financiar rreth 38.000 USD, të ardhura cash pjesë -pjesë ndër vite nga familjaret (familjet e, dajave të nënës dhe tezja e nënës), në SHBA, nga të cilët, jetojnë aktualisht dy dajat D. P. dhe R. P. dhe familjaret e tyre dhe për të cilët paraqet dokumentacionin e disponuar, si dhe diferenca rreth 4.000 USD nga interesat bankare ndër vite. Gjithashtu, subjekti saktësoi se: paraqet aplikimin me postë të shpejtë të R. Pe. por të marrë dokumentacionin e plotë të ardhurave të tij, dokumentacion të cilin do ta paraqesë në momentin e disponimit; paraqet një dokumentacion të nxjerrë nga sistemi online lidhur me taksat ndër vite të R. P. (deri në daljen në pension në vitin 2014), por për shkak të mënyrës së kërkimit nuk evidentohen gjeneralitetet e shtetasit përkatës.
- Lidhur me shumën 1.856.388 leke, subjekti konfirmoi sipas deklaramit duke saktësuar se gjyshja Sh. P. është ndarë nga jeta në datë 11.10.2012, duke sqaruar se, data 11.10.2011 është lapsus në formën e gabimit material në dokumentacionin e dorëzuar.
- Lidhur me asetet e dajës R. P., të menaxhuara nga nëna e tij Sh. Deliallisi, subjekti sqaroi se nuk ka përfituar të ardhura. Gjithashtu, subjekti sqaroi se shuma 3.000.000 leke ka kaluar në llogari të nënës Sh. Deliallisi nga llogaria e tij, me burim financiar kursime nga të ardhurat familjare ndër vite.
- Lidhur me shumën 20.000 euro për blerjen e karabinasë nga L. K., subjekti konfirmoi sipas deklaramit dhe sqaroi se shuma 2 000 euro dhe 3.000 euro janë shlyer nga gjendje të disponuar cash duke mos dashur të kryej veprime në llogarinë në euro ku është

kredituar huaja nga D. Xh. (hua e marrë me qellim pagesën e asetit), e cila është përdorur ne momentin e shlyerjes përfundimtare prej 15.000 euro në vitin 2021 duke zëvendësuar edhe shumat e shlyera nga gjendja e disponuar cash. Lidhur me burimin financiar të shumës 20.000 euro, subjekti sqaroi se D. Xh. ka shitur një pasuri të paluajtshme sipas kontratës datë 28.09.2018 (të cilën e paraqet), pasuri e cila është përfituar me leje legalizimi dhe për të cilat nuk disponon dokumentacion shtesë. Gjithashtu, subjekti sqaroi se, shuma e marrë hua prej 20.000 euro është pa afat shlyerje dhe e pandryshuar deri në momentin e deklarimit dhe aktualisht.

Bashkëlidhur praktikës:

- **Certifikatë regjistrimi pronësie** për pasurinë nr. ***, zk. ***, e ndodhur në Durrës, e Llojit apartament, me sipërfaqe 65.5 m², në bashkëpronësi të E. M. Deliallisi, me pjesë takuese 1/3.
- **Kontratë shitblerje** datë 04.12.1993, me blerës M. Deliallisi, Sh. Deliallisi dhe E. Deliallisi, shitës Ndërmarrja Komunale Banesa, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 65.5 m², të përbërë nga dy dhoma, kuzhinë, aneks dhe ambiente ndihmëse, të ndodhur në Durrës, me vlerën e likuiduar prej 10.443 lekë.
- **Kërkesë datë 14.04.2023**, nga M. Sh. Deliallisi (ish-punonjës i ish-Parkut të Mallrave në Shkozë, Durrës) drejtuar Raiffeisen Bank, për nxjerrjen e të dhënave të transaksioneve të tij gjatë periudhës 1998 - 2001.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze** lidhur me deklaratat e të ardhurave në SHBA, të D.P. dhe bashkëshortes së tij T. P., nxjerrë nga sistemi Turbotax për vitet 2020, 2021 dhe 2022, ku rezulton se të ardhurat bruto për periudhën 2016 - 2022, janë në shumën totale rreth 552.000 USD.
- **Printim i komunikimit me sms**, ku rezulton se: D.P. deklaroi që ka kërkuar të gjitha të dhënat lidhur me të ardhurat e tij prej vitin 1993 deri në vitin 2023, por sistemi Turbotax nuk i ruan këto të dhëna pasi ka kaluar afati dhe me këtë sistem të dhënash ka nxjerrë taksat dhe të ardhurat e tij për vitet 2020, 2021 dhe 2022 (gusht 2022 i dalë në pension). Bashkëlidhur: Dokument identifikimi i D.P. (pasaportë amerikane dhe leje drejtimi).
- **Dokumentacion në gjuhën angleze** lidhur me kërkesën datë 04.12.2023, të R. P. dhe bashkëshortes së tij Sanije P., për nxjerrjen e transkriptove të taksave për periudhën 01.01.1995 - 31.12.2012.
- **Dokumentacion i printuar nga sistemi “secure.ssa.gov”**, lidhur me taksat e paguara për periudhën 1994 - 2013, në shumën totale rreth 413.000 USD. Bashkëlidhur: Dokument identifikimi i shtetasit R. P. (leje drejtimi amerikane).
- **Kontratë shitje me rezervë** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2018, me shitës D.Xh. dhe blerës K. Gashi, për shitjen e pasurisë nr. ***, zk. ***, vol. ***, faqe ***, e llojit truall, me sipërfaqe 204 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 61 m², me adresë: Lagjja nr. ***, Plazh, Durrës. Vlera 55.000 euro, nga të cilat, shuma 20.000 euro paguhet me nënshkrimin e kontratës; shuma 33.000 euro do të paguhet brenda datës 30.09.2018 dhe shuma 2.000 euro do të paguhet deri në datën 31.12.2021. Bashkëlidhur: Kartela e pasurisë nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit truall, me sipërfaqe 204 m², nga e

cila, ndërtesë me sipërfaqe 61 m², me adresë: Plazh, Durrës, e regjistruar në emër të D. Xh., në datë 09.10.2013, me përshkrimin “*..Leje legalizimi nr. ***, datë 30.7.2013..*”

- **Amendim kontrate** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.9.2018, për ndryshimin e kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2018, për shitjen e pasurisë nr. ***, zk. ***, vol. ***, faqe ***, e llojit truall, me sipërfaqe 204 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 61 m², me adresë: Lagjja nr. ***, Plazh - Durrës, ku, pas ndryshimeve, kësti i dytë në shumën 33.000 euro do të paguhet në dy shuma dhe përkatësisht shuma 20.000 euro deri në datë 01.10.2018 dhe shuma 13.000 euro deri në datë 30.01.2019.

30. Në proces-verbalin e datës 15.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit,

subjekti ka saktësuar se një pjesë e mobilimit të apartamentit të blerë me sip. 105 m² ka qenë ekzistuese duke mos kryer shpenzime nga ana e tij përveç vlerës së blerjes sipas kontratës datë 15.07.2011. Lidhur me mobilimin e shtëpisë në mungesë të dokumentacionit, lidhur me vlerën e saktë të mobilimit të mbartur nga blerja e njërit prej apartamenteve (të bashkuar në vijim) dhe mobilimit të kryer nga ana e tij ndër vite, subjekti sqaroi se paraqet fotografi të ambienteve të brendshme së bashku me shpjegimet orientuese.

- Lidhur me shumën 42.325 USD dhe shumën 10.755 USD, subjekti ka konfirmuar sipas sqarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar dhe paraqet kopje të aplikimit me postë të shpejtë të D.P. për të marrë dokumentacionin e plotë e të ardhurave të tij, dokumentacion të cilin sqaroi se do ta paraqesë në momentin e disponimit.
- Lidhur me shumën e marrë hua nga kunata D.Xh., subjekti ka konfirmuar sipas sqarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar dhe paraqet kopje të dokumentacionit të legalizimit të pasurisë së shitur sipas kontratës së dorëzuar, duke sqaruar se për shkak të tjetërsimit të pasurisë nuk disponon dokumentacion shtesë lidhur me vlerën e ndërtimit apo kontributin monetar që ka shërbyer për ndërtimin, për të cilin sqaron se nuk ka patur asnjë interes personal pasuror.

Subjekti ka dorëzuar dokumentacion shtesë:

- Fotografi me shpjegime orientuese të ambienteve të brendshme të apartamentit të banimit.
- Dokumentacion në gjuhën angleze lidhur me kërkesën datë 07.12.2023, të D. P. dhe bashkëshortes së tij T, P., për nxjerrjen e transkriptove të taksave për periudhën 31.12.1997- 31.12.2019.

31. Në proces-verbalin e datës 19.1.2024, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit,

lidhur me të ardhurat e dajave D.P. dhe R. P., subjekti ka konfirmuar sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur duke saktësuar se ende nuk ka siguruar dokumentacionin e kërkuar nga institucionet në SHBA dhe se sipas komunikimit me dajën R. P., dhe duke qenë se i është komunikuar si e nevojshme nga institucionet përgjegjëse në SHBA, ai ka rinisur kërkesën për informacion lidhur me të ardhurat e tij për periudhën 01.01.2000 - 01.01.2013, në datën 07.01.2024.

Bashkëlidhur praktikës:

- **Dokumentacion në gjuhën angleze** datë 22.12.2023, kthim përgjigje nga RAIVS, drejtuar R. P. lidhur me pamundësinë e gjetjes së dokumentacionit të kërkuar.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze**, lidhur me kërkesën datë 07.01.2024, të R. P. dhe bashkëshortes së tij Sanije P., për nxjerrjen e transkripteve të taksave për periudhën 01.01.2000 - 01.01.2013.
- **Deklaratë e firmosur nga M. Deliallisi** dhe Bujar Deliallisi, në datën 15.01.2024, ku M. Deliallisi deklaron se ka përfituar të ardhura në vlerën 1.200.000 lekë nga shitja e aksioneve të Parkut të Mallrave Durrës, në vitin 1998, shumë e cila është përdorur për financimin e shtëpisë së djalit të tij Bujar Deliallisi, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.07.2011. Bujar Deliallisi konfirmon sa më sipër.
- **Deklaratë e firmosur nga Sh. Deliallisi** dhe Bujar Deliallisi, në datën 15.01.2024, ku Sh. Deliallisi deklaron se ka përfituar shumën 10.755 USD nëpërmjet transfertë bankare në vitin 2011 nga vëllai i saj D. P., shumë e cila është përdorur për financimin e shtëpisë së djalit të saj Bujar Deliallisi, sipas kontratës datë 15.07.2011. Gjithashtu, Sh. Deliallisi deklaron se ka përfituar shumën 1.856.388 lekë, si e ardhur nga pensioni i nënës së saj, Sh. P.; ka përfituar shumën 525.000 lekë si të ardhura nga pensioni dhe dëmshpërblimi si i burgosur politik i vëllait të saj R. P.; si dhe ka përfituar shumën 304.205 lekë nga letrat me vlerë, shuma të cilat janë përdorur për financimin e shtëpisë së djalit të saj Bujar Deliallisi, sipas kontratës datë 15.07.2011. Bujar Deliallisi konfirmon sa më sipër.
- **Deklaratë e firmosur nga Sh. Deliallisi, E. Deliallisi** dhe Bujar Deliallisi, në datën 15.01.2024, ku Sh. Deliallisi deklaron se ka përfituar ndër vite nga vëllezërit e saj shuma të ndryshme cash (sipas deklaratave noteriale të Durim dhe R. P.), shuma të cilat janë depozituar me miratimin e saj nga vajza Ermira Deliallisi në RFZ Bank në vitin 2007 dhe janë tërhequr në vitin 2008 në vlerën 42.325 USD, nga të cilat, 4.000 USD janë interesa bankare, janë disponuar pjesërisht cash dhe pjesërisht për financimin e llogarisë së saj bankare deri në vitin 2011 kur janë përdorur për blerjen e apartamentit të djalit Bujar Deliallisi, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 1104 rep., nr. 506/1 kol., datë 15.07.2011. Ermira Deliallisi dhe Bujar Deliallisi konfirmojnë sa më sipër.
- **Dokumentacion i dërguar nga D.P.** lidhur me përgjigjen e institucioneve në SHBA, ku rezulton se disponon dokumentacion për periudhën 2008 - 2019; duke saktësuar se në kthimin e përgjigjes është cituar se nuk mund të sigurohej i gjithë dokumentacioni i kërkuar.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze** datë 29.12.2023, kthim përgjigje nga RAIVS drejtuar D.P. lidhur me dokumentacionin e kërkuar.
- **Dokumentacion në gjuhën angleze** lidhur me deklaratat e të ardhurave në SHBA, të D.P. dhe bashkëshortes së tij Tefta P., nxjerrë nga sistemi Turbotax për vitet 2008, 2009, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2017, 2019, ku rezulton se të ardhurat bruto për periudhën 2008 - 2019, janë në shumën totale rreth 797.000 USD.

32. Me emalin e datës 12.07.2024, pyetjeve së dërguar nga Relatori i çështjes, subjekti ka sqaruar se “...në lidhje me shumën prej 42.325 Usd, kjo shumë është mbledhur në periudha (vizitash) apo rastesh të ndryshme festash familjare dhe sa herë të afërmit e nënës sime na

kanë vizituar nga SHBA-ja. Kjo shumë ka qenë mbledhur me fanatizëm nga ana e nënës sime dhe pa u shpërdoruar ndër vite. Në total kjo shumë është përdorur nga ne si familje, së bashku me të ardhura të tjera, për blerjen e apartamentit tim. Kjo shumë nuk është as dhurim dhe as hua nga familja ime, pasi unë dhe motra ime kemi qene pjese e familjes sime (babai, nënë dhe motër) sipas certifikatës familjare të dorëzuar në ILKKPI dhe deklaroj se nuk kam marrë hua dhe as dhurim prej tyre. Thjeshtë me këto para dhe të ardhura të tjera të familjes sonë, është bërë blerja e apartamentit tim në vitin 2011...”.

33. Konkluzione:

Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të pasurisë së subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të, nëpërmjet analizës dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit dhe korrespondenca me institucionet ligjzbatuese.

Në përfundim të veprimtarisë verifikuese të kryer në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, Trupa e Vlerësimit bazuar në parimin e kontradiktoritetit do të mbështetet edhe në shpjegimet që do të japë subjekti i vlerësimit pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancë dëgjimore.

Pasuria nr. 2

✚ Garazh me sipërfaqe totale 74 m², nga të cilat, sipërfaqe ndërtimi 42.61 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 31.95 m², në të njëjtën adresë me apartamentin. Blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.01.2017.

Vlera: 5.000 euro. Zotëron 50% dhe bashkëshortja 50%.

Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat familjare (periudha 2011 - 2017).

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.01.2017, me porositës Bujar Deliallisi dhe sipërmarrës shoqëria “Lim-Em” shpk, për ndërtimin e një garazhi me sipërfaqe totale 74 m², nga të cilat, sipërfaqe ndërtimi 42.61 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 31.95 m², në objektin godinë banimi dhe shërbim 2 - 6 kat mbi tokë + 1 kat nën tokë, me adresë: Lagjja nr. ***, Rruga ***, Durrës. Vlera 5.000 euro, e likuiduar.

34. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **ASHK (online)**, konfirmon pasurinë nr. ***, vol. 61, faqe ***, zk. ***, e ndodhur në Durrës, në bashkëpronësi të Bujar H. Deliallisi dhe Oneda B. Deliallisi, me status “mbyllur” dhe përshkrim “*..kërkesë nr. 218203 datë 10.7.2018, përditësim dhe leje transaksioni me afat 30 ditor..*”
- **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në llogari të Bujar Deliallisi, rezulton: debitimi cash i shumës 1.700.000 lekë, në datën 18.01.2017.

Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar se vlera e blerjes së garazhit është deklaruar sipas shumës së shlyer prej 5.000 euro, si dhe sqaroi se shuma e debituar cash nga llogaria në Raiffeisen Bank ka shërbyer pjesërisht për financimin e blerjes së garazhit dhe diferenca për shpenzime të tjera për të cilat nuk disponon dokumentacion vërtetues dhe nuk rikujton saktësisht destinacioni. Gjithashtu, subjekti sqaroi se, ka paraqitur kërkesën drejtuar ASHK-së, për saktësimin e gjeneraliteteve nga Bujar H. Deliallisi në Bujar M. Deliallisi.

Subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues:

- **Kërkesë nr. ***, datë 24.11.2023 drejtuar ASHK Durrës**, kërkesën, për lëshimin “*korrigjimin e emrit të pronarit sipas certifikatës së pronësisë së datës 17.7.2018 (bashkëlidhur) nga Bujar H. Deliallisi në Bujar M. Deliallisi*”.
- **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. 1623209, datë 17.07.2018**, për pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk. ***, e llojit garazh, me sipërfaqe 42.61 m², i ndodhur në Durrës, në bashkëpronësi të Bujar Halil Deliallisi dhe Oneda B. Deliallisi.
- **Certifikatë regjistrim pronësie datë 19.01.2024**, për pasurinë nr. ***, zk. ***, e llojit garazh, me sipërfaqe 42.61 m², i ndodhur në Durrës, regjistruar në emër të Bujar M. Deliallisi, me pjesë takuese 1/2.

35. Konkluzione:

- ✓ Garazhi me sipërfaqe totale 74 m², nga të cilat, sipërfaqe ndërtimi 42.61 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 31.95 m², i ndodhur në Lagjen nr. ***, Rruga ***, Durrës, në zotërim 100% të subjektit dhe bashkëshortes së tij, është blerë në vitin 2017, për shumën 5.000 euro, me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare.

PASURI TË LUAJTSHME

- 🚗 Automjeti i përdorur, marka Land Rover Discovery II, vit prodhimi 2000, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2018. Vlera: 200.000 lekë.

Burimi i krijimit: Kursime personale periudha, viti 2011 - 2018.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shit-blerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2018**, me blerës Bujar Deliallisi dhe shitës F.S., për blerjen e automjetit të përdorur tip Land Rover Discovery II, viti prodhimi 2000 me nr. shasie ***, targë AA***JB. Vlera 200.000 lekë.

36. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Subjekti në Deklaratën e Pasurisë ka deklaruar vetëm automjetin e disponuar në pronësi. Për të verifikuar të gjitha mjetet të cilat ka disponuar ndër vite është bërë kërkesë pranë DPSHTRR.

- **DPSHTRR me shkresën nr. *** prot., datë 10.08.2023**, konfirmon se Bujar Deliallisi ka patur të regjistruar në pronësi mjetet me targa AA***CL (AA***XE), AA***KB (AA***XA).

Bazuar në përgjigjen e DPSHTRR, rezulton se subjekti ka disponuar dhe ka tjetërsuar mjetet si më poshtë vijon:

- **Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2011**, me blerës Bujar Deliallisi dhe shitës E. P., për blerjen e automjetit tip Audi Q7, me targë AA***CL (AA605XE) dhe me nr. shasie ***. Vlera 1.400.000 lekë.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.03.2014**, me shitës Bujar Deliallisi dhe blerës A. H., për shitjen e automjetit tip Audi Q7, me targë AA***CL, dhe me nr. shasie ***. Vlera 500.000 lekë, e likuiduar.
- **Kontratë shitblerje datë 26.07.2014 me faturë tatimore shitje, nr. ***, datë 26.07.2014** me blerës Bujar Deliallisi dhe shitës “***” shpk, për blerjen e automjetit tip Audi, me targë AA***KB (AA***XA) dhe me nr. shasie ***. Vlera 504.000 lekë, e likuiduar cash, sipas faturës tatimore të shitjes.
- **Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.01.2016**, me shitës Bujar Deliallisi dhe blerës A.T., për shitjen e automjetit tip Audi A8, me targë AA***KB dhe me nr. shasie ***. Vlera 5.000 euro.

37. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se për shkak të mos dijes së informacionit të saktë, ka deklaruar vetëm automjetin e disponuar në pronësi duke konfirmuar automjetet e rezultuara sipas përgjigjes së DPSHTRR-së, të cilat për shkak të tjetërsimit të pronësisë nuk janë evidentuar në formular. Gjithashtu, subjekti sqaroi se, duke qenë pasuri të regjistruara në regjistra publikë, me burim financiar të ligjshëm dhe lehtësisht të verifikueshme, nuk kam patur asnjë arsye apo qëllim mos deklarimi.

Lidhur me automjetet e disponuara ndër vite, subjekti sqaroi se si burim financiar kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat ndër vite. Gjithashtu, subjekti sqaroi se, automjetin e deklaruar në pronësi e disponon sipas kontratës së blerjes, duke saktësuar se kontrata nuk është depozituar ende në zyrat e DPSHTRR-së për shkak të kalimit të afatit 30-ditor dhe automjeti disponon leje qarkullimi në emër të palës shitëse.

Subjekti ka dorëzuar dokumentacion shtesë:

- **Leje qarkullimi** për automjetin me targë AA***JB, në emër të F.S.

38. Në proces-verbalin e datës 19.01.2024 të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se automjetin tip Land Rover II me targë AA***JB, e ka regjistruar në emrin e tij dhe në vijim e ka shitur.

Subjekti ka dorëzuar dokumentacion shtesë:

- **Leje qarkullimi** për automjetin me targë AA***JB, në emër të Bujar Deliallisi, regjistruar në datën 26.12.2023.

- **Kontratë shitje nr. *** rep. , nr. *** kol., datë 12.01.2024**, me shitës Bujar Deliallisi dhe blerës Klajdi Capo, për shitjen e automjetit tip Land Rover, vit prodhimi 2000, me nr. shasje ***, targë AA***JB. Vlera 5.000 euro.

39. **Konkluzione:**

- ✓ Automjeti tip Audi Q7, me targë AA***CL (AA***XE), rezulton të jetë blerë në vitin 2011, në vlerën 1.400.000 lekë, dhe të shitur në vitin 2014, në vlerën 500.000 lekë. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet personale nga të ardhurat ndër vite.
- ✓ Automjeti tip Audi A8, me targë AA***KB (AA***XA), rezulton të jetë blerë në vitin 2014, në vlerën 504.000 lekë dhe të shitur në vitin 2016, në vlerën 5.000 euro. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet personale nga të ardhurat ndër vite.
- ✓ Automjeti tip Land Rover, me targë AA***JB, rezulton të jetë blerë në vitin 2018 në vlerën 200.000 lekë dhe të shitur në datë 12.01.2024, në vlerën 5.000 euro. Burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet personale nga të ardhurat ndër vite.

- 🚦 Llogari rrjedhëse në emër të Bujar Deliallisi, në EURO, pranë Raiffeisen Bank, me gjendje në datën e deklarimit. Vlera: 0 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim mbi produktet bankare** nga Raiffeisen Bank, datë 04.04.2023, ku rezulton se klienti Bujar Deliallisi disponon llogari rrjedhëse me balancë -4.85 euro, në datën 01.01.2023.

40. **Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:**

- **Raiffeisen Bank. me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në emër të Bujar Deliallisi rezulton llogari rrjedhëse me balancë -5.19 euro, në datën 28.04.2023.

41. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar balancën sipas përgjigjes së Raiffeisen Bank dhe sqaroi se balanca e deklaruar është referuar në statement bankar të dorëzuar e cila i përket datave para dorëzimit të deklaratës së pasurisë.

42. **Konkluzione:**

- ✓ Llogaria në Raiffeisen Bank është krijuar gjatë periudhës 2012 - 2023. Subjekti ka konfirmuar balancën sipas përgjigjes së Raiffeisen Bank.
- 🚦 Llogari rrjedhëse në emër të Bujar Deliallisi, në ALL (Albanian Lek), pranë Raiffeisen Bank, me gjendje në datën e deklarimit për dy llogari.

Llogaria e I, Vlera: 0 lekë. Llogaria e II, Vlera: 0 lekë.

Burimi i krijimit: Paga e subjektit si punonjës policie.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim mbi produktet bankare nga Raiffeisen Bank**, datë 04.04.2023, ku rezulton se klienti Bujar Deliallisi disponon llogari rrjedhëse (page), me balancë 325.117 lekë, në datën 01.01.2023 dhe llogari rrjedhëse (page) me balancë -716 lekë, në datën 01.01.2023.
- **Statement nga Raiffeisen Bank**, printuar në datën 04.04.2023, për llogarinë e pagës në emër të Bujar Deliallisi, me balancë 325.117 lekë, në datën 01.01.2023 dhe 0 lekë në datën 04.04.2023.

43. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në emër të Bujar Deliallisi rezulton llogari page me balancë 203.268 lekë, në datën 28.04.2023 si dhe llogari rrjedhëse me balancë -788 lekë, në datën 28.04.2023.

44. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar balancat sipas përgjigjes së Raiffeisen Bank dhe sqaroi se balancat e deklaruara janë referuar në statement bankar të dorëzuar të cilat i përkasin datave para dorëzimit të deklaratës së pasurisë. Gjithashtu, subjekti sqaroi se duke qenë se likuiditete bankare me burime financiare të ligjshme janë lehtësisht të verifikueshme, nuk ka patur asnjë arsye apo qëllim deklarimi të pasaktë.

45. Konkluzione:

- ✓ Llogaritë ALL në Raiffeisen Bank janë krijuar gjatë periudhës 2005 - 2023.

🚩 Llogari rrjedhëse në emër të Bujar Deliallisi, në USD, pranë Raiffeisen Bank, me gjendje në datën e deklaramit. Vlera: 5.000 USD.

Burimi i krijimit: Donacion.

Sqarimi i subjektit: Në llogarinë në USD, në datë 12.07.2021, më është transferuar nga djali i dajës, shtetasi amerikan S. P., shuma prej 5.000 USD, me shënimin “*family support*”. Kjo shumë është ajo që ka ngelur në llogarinë bankare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim mbi produktet bankare nga Raiffeisen Bank, datë 04.04.2023, ku rezulton se klienti Bujar Deliallisi disponon llogari rrjedhëse me balancë 5.072 USD, në datën 01.01.2023, ku rezulton se është kredituar shuma totale 5.072 USD, në vitin 2021.

46. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në emër të Bujar Deliallisi rezulton llogari rrjedhëse me balancë 70 USD, në datën 28.04.2023. Referuar në statement bankar, rezulton: “ *kreditimi me transfertë nga Siris P. i shumës 986 USD dhe i shumës 4.086 USD, në datën 12.07.2021, me përshkrimin “.family support.. “; si dhe debitimi cash i shumës 5.001 USD në datën 04.04.2023.*

47. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar balancën sipas përgjigjes së Raiffeisen Bank dhe sqaroi se balanca e deklaruar është referuar në statement bankar të dorëzuar e cila i përket një datë para dorëzimit të deklaratës së pasurisë. Gjithashtu, subjekti sqaroi se duke qenë likuiditet bankar me burime financiare të ligjshme dhe lehtësisht të verifikueshme, nuk ka patur asnjë arsye apo qëllim deklarimi të pasaktë, duke saktësuar se shuma e tërhequr nga llogaria ka patur si destinacioni pagesën e një pjese të shpenzimit për shkollimin e fëmijëve dhe shpenzime konsumi të tjera.

48. Subjektit ju kërkua të paraqesë dokumentacion vërtetues lidhur me të ardhurat e S.

P. për periudhën 2019 - 2021, të cilat kanë shërbyer si burim financiar për shumën rreth 5.000 USD të transferuar në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me të ardhurat e shtetasit S. P. i cili është djali i dajës së tij:

- **Dokumentacion në gjuhën angleze nga Departamenti i Thesarit të Shteteve të Bashkuara**, datë 28.11.2023, lidhur me të ardhurat e taksapaguesit “S.. Pesh.. “, ku rezulton se për vitin 2019 ka realizuar të ardhura bruto në vlerën totale rreth 34.250 USD
- **Dokumentacion në gjuhën angleze nga Departamenti i Thesarit të Shteteve të Bashkuara**, datë 03.12.2023, lidhur me të ardhurat e taksapagueseve “Gabr.. G. dhe Siri.. Pesh..”, ku rezulton se për periudhën 2020 - 2021, kanë realizuar të ardhura bruto në vlerën totale rreth 220.000 USD.

49. Konkluzione:

Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të pasurisë së subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të, nëpërmjet analizës dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit dhe korrespondenca me institucionet ligjzbatuese.

Në përfundim të veprimtarisë verifikuese të kryer në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, Trupa e Vlerësimit bazuar në parimin e kontradiktoritetit do të mbështetet edhe në shpjegimet që do të japë subjekti i vlerësimit pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancë dëgjimore.

 Gjendje Cash, të krijuara nga kursimet familjare. Vlera: 900.000 lekë.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, shpërblime, honorarë dhe dieta, orë suplementare, të subjektit,

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Në periudhën 1.3.2000 - 31.7.2003**, në pozicionin Inspektor i Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Policisë Durrës (sipas vërtetimit, lëshuar nga D.V.P Durrës).
- **Në periudhën 1.8.2003 - 1.5.2005**, në Drejtorinë e Policisë Kukës (sipas vërtetimit datë 26.4.2018).
- **Në periudhën maj 2005 - shkurt 2006**, si Specialist i Policisë Kriminale, në Komisariatin e Policisë Shkodër (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.4.2023).
- **Në periudhën shkurt 2006 - qershor 2007**, si Specialist i Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Policisë Durrës (Porti), (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.4.2023).
- **Në periudhën qershor - korrik 2007**, si Komandant i PKK, në Rajonin e Policisë Shëngjin, Lezhë (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.4.2023).
- **Në periudhën korrik 2007 - tetor 2012**, si Specialist i Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Policisë Durrës (Porti). (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.4.2023).
- **Në periudhën nëntor 2012 - janar 2014**, si përgjegjës turni në PKK Morinë, në DRKM Kukës (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.04.2023).
- **Në periudhën shkurt 2014 - maj 2019**, si specialist për hetimin e krimeve narkotike, në DVP Durrës (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.04.2023).
- **Në periudhën qershor 2019 - prill 2020**, në pozicionin Shef seksioni, në DVP Gjirokastrë. (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.04.2023).
- **Në periudhën prill 2020 - shtator 2021**, në pozicionin Shef seksioni, në DVP Shkodër (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.04.2023). Në periudhën shtator 2021 - nëntor 2022, në pozicionin Shef seksioni, në DVP Durrës (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.04.2023).
- **Në periudhën nëntor 2022 - mars 2023**, në pozicionin Shef seksioni, në DVP Korçë (sipas statement të Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 27.04.2023). Bashkëlidhur deklaratës.

50. Konkluzione:

- ✓ Subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi ka patur mundësi të krijojë të ardhurat cash, të krijuara nga kursimet familjare nga paga, shpërblime, honorarë dhe dieta, orë suplementare, të subjektit.

(Hetimi i trupës së vlerësimit do të trajtohet më poshtë në rubrikën “Deklarimi i të Ardhurave”).

DETYRIME FINANCIARE

- ✚ Detyrim financiar, hua, e marrë me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.09.2018, pa afat dhe pa interes. Huadhënës motra e bashkëshortes, shtetasja D.Xh. Shuma është depozituar në llogarinë në EURO në Raiffeisen Bank në emër të Bujar Deliallisi, me nr. ***, e hapur për këtë transaksion dhe është përdorur për blerjen e karabinasë (*trajtuar më lart*). Shuma e detyrimit financiar: 20.000 euro.

Shënim i subjektit të vlerësimit: Motra e bashkëshortes i ka krijuar këto të ardhura nga shitja e një pasurie të paluajtshme, të regjistruar në emër të saj.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.09.2018**, me deklarues debitor Bujar Deliallisi dhe deklarues kreditor D. Xh., ku debitori Bujar Deliallisi deklaroi se “...i detyrohet palës kreditore D. Xh. shumën monetare prej 20.000 euro, të cilën ajo ja ka dhënë në formë borxhi, sot, në datë 01.09.2018, dhe e kredituar në emrin e tij në Raiffeisen Bank dhe këtë shumë monetare do ta kthej me kërkesën e palës kreditore ndaj tij, duke njohur detyrimin dhe marrë përsipër kthimin e shumës...”. D. Xh. deklaroi se “është plotësisht dakord me sa më sipër”.

51. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Mandat depozitimi nga Raiffeisen Bank, datë 01.09.2018**, me urdhërues D. Xh. dhe përfitues Bujar Deliallisi, për shumën 20.000 euro, me përshkrimin “..Hua sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.09.2018”.
- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në llogari të shtetasit Bujar Deliallisi është kredituar shuma 20.000 euro, në datën 01.09.2018, me përshkrimin “..D. Bilbil Xh., jep hua sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.09.2018.. “ dhe debitimi cash i shumës 19.987 euro, në datën 23.02.2021.

52. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar sipas deklaramit dhe lidhur me burimin financiar të shumës 20.000 euro, sqaroi se “...zgj. D. Xh. ka shitur një pasuri të paluajtshme sipas kontratës datë 28.09.2018), pasuri e cila është përfituar me leje legalizimi për të cilën nuk disponon dokumentacion shtesë dhe se shuma e marrë hua prej 20.000 euro është pa afat shlyerje dhe e pandryshuar deri në momentin e deklaramit dhe aktualisht”.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë shitje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.04.2018**, me shitës D.Xh.dhe blerës K.G., për shitjen e pasurisë nr. ***, zk. ***, vol. ***, faqe ***, e llojit truall, me sipërfaqe 204 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 61 m², me adresë: Lagjja nr. 13, Plazh - Durrës. Vlera 55.000 euro, nga të cila, shuma 20.000 euro paguhet me nënshkrimin e kontratës, shuma 33.000 euro do të paguhet brenda datës 30.09.2018 dhe shuma 2.000 euro do të paguhet deri në datën 31.12.2021.
- **Kartela e pasurisë nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ****, e llojit truall, me sipërfaqe 204 m², nga e cila, ndërtesë me sipërfaqe 61 m², me adresë lagjja *** Plazh, Durrës, e

regjistruar në emër të D.Xh., në datë 09.10.2013, me përshkrimin "Leje legalizimi nr. ***, datë 30.7.2013.. "

- **Amendim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.09.2018**, për ndryshimin e kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2018, për shitjen e pasurisë nr. ***, zk. 8518, vol. 105, faqe 51, e Llojit truall, me sipërfaqe 204 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 61 m², me adresë: Lagjja nr. **, Plazh - Durrës, ku, pas ndryshmeve, kësti i dytë në shumën 33.000 euro do të paguhet në dy shuma dhe përkatësisht shuma 20.000 euro deri në datë 01.10.2018 dhe shuma 13.000 euro deri në datë 30.01.2019.
- **Leje legalizimi nr. 99700, datë 30.7.2013**, në emër të Diola Bilbil Xhango, për legalizimin e godinës së banimit l-kat, me sipërfaqe 61 m² për banim dhe sipërfaqe trualli 204 m².

53. Konkluzione:

- ✓ Huaja në shumën 20.000 euro është marrë në vitin 2018, për blerje pasurie të paluajtshme (apartamentin në Rr. "****", Durrës), pa afat shlyerje dhe është pandryshuar deri në momentin e deklaramit.

- ✚ Detyrim financiar në formën e kartës së kreditit, në Raiffeisen Bank, me limit 400 euro. Shuma e detyrimit financiar: 0 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim mbi produktet bankare nga Raiffeisen Bank datë 04.04.2023**, ku rezulton se klienti Bujar Deliallisi disponon Llogari Master Card me limit balance 440 euro, në datë 01.01.2022.

54. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në emër të Bujar Deliallisi rezulton llogari për tërheqje Master Card, me balancë 0 euro, në datë 28.04.2023 dhe llogari ngurtësimi 440 euro, në datë 28.04.2023.

55. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar sipas përgjigjes së bankë dhe shpjegon se llogaritë Master Card në Raiffeisen Bank janë krijuar gjatë periudhës 2012 - 2023.

56. Konkluzione:

- ✓ Subjekti disponon kartë krediti Master Card, hapur në Raiffeisen Bank, me garanci të depozituar në llogari 440 euro.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- ✚ Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur.

Subjekti ka deklaruar shpenzime për vitin e fundit, për furnizimin me energji elektrike, ujë, telefoni, internet, për periudhën janar - dhjetor 2022. Shuma e shpenzimeve: 183.684 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kthim përgjigje nga FSHU, me nr. *** prot., datë 24.4.2023**, ku vërtetohet se për kontratën nr. ***, me titullar Bujar Deliallisi, kategoria “familjar AP”, aktive prej datës 30.09.2008, rezulton të jenë kryer pagesat për vitin 2022, në shumën totale 37.282 lekë.
- **Librezë furnizimi me energji elektrike nga FSHU**, për kontratën nr. *** Durrës, në emër të N.K, ku vërtetohet se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 64.157 lekë.
- **Librezë furnizimi me energji elektrike nga FSHU**, për kontratën nr. *** Durrës, në emër të Agim Vrioni, ku vërtetohet se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 55.173 lekë.
- **Vërtetim nga Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, nr. *** prot., datë 24.04.2023**, ku vërtetohet se klienti Bujar Deliallisi, me kontratë nr. ***, me adresë: Lagjja nr. ***, Rruga ***, rezulton të ketë paguar detyrimet me vlerë 31.844 lekë, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
- **Librezë furnizimi me ujë nr. *****, në emër të Bujar Deliallisi, ku vërtetohet se për vitin 2022 janë kryer pagesat në shumën totale rreth 31.842 lekë.

57. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023**, konfirmon se me gjeneralitetet Bujar M. Deliallisi identifikohet një abonent me kontratë furnizimi për energji elektrike me kontratë nr. *** datë 30.09.2008, kategoria “Familjar AP”, adresa: “****”, Durrës. Referua të dhënave të faturës, për periudhën janar - dhjetor 2022, rezulton se pagesa e detyrimeve totale në shumën rreth 51.190 lekë dhe shumës së prapambetur me vlerë totale rreth 37.504 lekë.
- **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë sh.a., me shkresën nr. *** prot., datë 21.08.2023**, konfirmon se në emër të Bujar Deliallisi rezulton: Kontrata nr. ***, për objektin me adresë: Rrugën “****”, me status “aktive”, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në qershor 2023, ku citohet se “*nuk disponohet asnjë dokumentacion i arkivuar dhe nuk është e sigurtë nëse është i njëjti person me shtetasin Bujar M. Deliallisi, për të cilin është kërkuar informacion*”.
- **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Durrës sh.a., me shkresën nr. *** prot., datë 16.08.2023**, konfirmon se në emër të Bujar Deliallisi rezulton: Kontrata nr. ***, me adresë: Lagjja nr. 1, Firma “****” Durrës, ku citohet se “*nuk disponohet asnjë dokumentacion apo kopje e kontratës dhe nuk është e sigurtë nëse është i njëjti person me shtetasin Bujar M. Deliallisi, për të cilin është kërkuar informacion*”.
- **Shoqëri Ujësjiellës - Kanalizime me shkresat nr. ***- ***prot., dhe nr. ***- ***prot., datë 08.08.2023 deri në datë 28.02.2024**, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

- **Vodafone Albania sh.a., me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2023**, konfirmon se për vitin 2022 në emër të Bujar Deliallisi rezulton një numër telefonik për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 24.000 lekë, si dhe në emër të Oneda Deliallisi rezulton një numër telefonik për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 19.100 lekë.
- **One Albania sh.a. me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për vitin 2022. Albania Satellite Communications shpk me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- **Abissnet sh.a. me shkresën nr. *** - prot., datë 14.8.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
- **Digicom sh.a. me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

58. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se “...deklarimi i shpenzimeve është referuar sipas dokumentacionit të paraqitur, duke mbledhur shumën rreth 37.282 lekë, si pagesa për energji elektrike të kontratës nr. *** (referuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 24.04.2023), kontratë e cila i referohet *** librezës në emër të *** para ndryshimit në emrin e tij Bujar Deliallisi (për apartamentin e blerë nga shoqëria “****” shpk., e cila ka patur një marrëdhënie juridike me A. V., për të cilën nuk disponon dokumentacion shtesë), duke mbledhur shumën rreth 64.157 lekë, si pagesa për energji elektrike sipas librezës në emër të *** (e cila nuk është saktësuar ende si librezë në emrin e tij) dhe duke mbledhur shumën rreth 31.844 lekë, për shpenzime furnizimi me ujë, sipas dokumentacionit të paraqitur...”. Ai saktësoi se “...ka kryer shpenzime për furnizim me internet, për të cilat sqaroi se nuk janë evidentuar në formular për shkak të mungesës së dokumentacionit në momentin e plotësimit të formulari...”.

59. Në proces-verbalin e datës 15.12.2023. të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka saktësuar se “...përveç shumave për shpenzime të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë ka llogaritur në shumën e deklaruar edhe shpenzimet për telefon: përkatësisht shumën 2.000 lekë/muaj për numrin e tij personal, shumën 600 lekë/muaj për numrin e tij të punës dhe shumën 1.600 lekë/muaj për numrin personal të bashkëshortes, me vlerë totale rreth 50.400 lekë për vitin 2022...”. Subjekti vazhdoj të sqarojë se “se lidhur me shpenzimet për internet, subjekti sqaroi se paraqet dokumentacion vërtetues lidhur me pagesat e kryera, nga të cilat, për periudhën janar - korrik 2022 pagesa është likuiduar sipas faturës datë 13.08.2021 dhe pagesa për periudhën gusht - dhjetor 2022 është likuiduar sipas faturës datë 11.08.2022”.

Bashkëlidhur deklarimeve subjekti ka paraqitur material shtesë:

- i. **Printim i njoftimeve me sms nga Vodafone**, për detyrimet e pagesave mujore me vlerë 600 lekë/muaj, për vitin 2023, (klienti: Bujar Deliallisi, Komisariati i Policisë Port - Durrës).
- ii. **Printim i njoftimeve me sms nga Vodafone**, për detyrimet e pagesave mujore me vlerë rreth 2.000 lekë/muaj, për vitin 2022, (klienti: Bujar Deliallisi).
- iii. **Printim i njoftimeve me sms nga Vodafone**, për detyrimet e pagesave mujore me vlerë rreth 1.600 lekë/muaj, për vitin 2022, (klienti: Oneda Deliallisi).
- iv. **Formular regjistrimi për kontratë 12 mujore**, datë 13.08.2021, me klient Bujar Deliallisi dhe operator shoqëria Nisa tel shpk, për shërbimin internet me vlerë totale 18.000 lekë. Formular regjistrimi për kontratë 12 mujore, datë 11.08.2022, me klient Bujar Deliallisi dhe operator shoqëria Nisa tel shpk, për shërbimin internet me vlerë totale 19.200 lekë.

60. Në proces-verbalin e datës 15.12.2023. të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti nuk e konfirmon kontratën nr. 008565-1, me adresë: Rr. "****", me status 'aktive', në kategorinë e konsumatorëve familjarë, duke sqaruar se *"...nuk disponon asnjë aset apo kontratë furnizimi në Tiranë, ndërkohë që konfirmon kontratën nr. 1071421, me adresë: Lagjia nr. 1, Firma '*** Durrës, e cila i përket apartamentit të banimit..."* sipas deklarimit duke saktësuar se disponon vetëm një kontratë furnizimi me uji.

- **Nga përlllogaritja e shpenzimeve rezulton se subjekti ka bërë keq llogaritje të shpenzimeve të deklarueshme dhe ri llogaritja bazuar nga letër këmbimi me institucionet përgjegjëse rezulton:**

61. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzimet për ujë, (janar - dhjetor 2022), **31.844 lekë.**
- Shpenzimet për energji elektrike (janar - dhjetor 2022), **156.612 lekë.**
- Shpenzimet për internet (janar - dhjetor 2022), **18.000 lekë.**
- Shpenzime për telefonin celular *****, **31.200 lekë**
- Shpenzime për telefonin celular *****, **19.200 lekë**
- ✓ **Total 256.856 lekë.**

62. Konkluzione:

- ✓ Subjekti për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 ka shpenzuar në total 256.856 lekë, për të cilat rakordohen deklarimet me shkresat e ardhura nga institucionet përkatëse.
- ✓ Nga subjekti nuk është bërë fshehje e shpenzimeve.

SHPENZIME PËR UDHËTIME

63. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022:

- Shpenzim për udhëtim turistik në Dubai në dhjetor 2022, duke përfshirë udhëtim + akomodim. Faturë tatimore lëshuar nga Matias Taraveli. Shuma e shpenzuar: 1.000 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Faturë tatimore shitje** datë 19.12.2022, me blerës Bujar Deliallisi dhe shitës Matias Travel Bis, për pagesën e paketës turistike me vlerë 1.000 euro (të likuiduar).
- **Printim i kërkimit nga sistemi TIMS**, ku vërtetohet se shtetasit Bujar Deliallisi, Oneda Deliallisi, D.D.dhe D.D. kanë udhëtuar në dalje nga Aeroporti i Rinasit në datën 21.12.2022 dhe kanë udhëtuar në hyrje nga Aeroporti i Rinasit, në datën 26.12.2022.

64. Konkluzione:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje - daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022 të subjektit dhe personave të lidhur me të.

65. Subjekti deklaroj shpenzimet për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vetore, si dhe kohën e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018:

- Institucionin arsimor Albanian College, studimet në kurrikula ndërkombëtare IB:

Viti 2018 - 2019: D.D., (paguar nga motra ime E. Deliallisi nga kursimet familjare, pasi motra është beqare dhe jeton me prindërit). **Shuma e shpenzuar: 3.000 euro.**

Viti 2019 - 2020: D. dhe D.D., (paguar nga vëllai i bashkëshortes, E. Xh., shumë e krijuar nga biznesi i tij dhe të ardhurat familjare të prindërve të bashkëshortes). **Shuma e shpenzuar: 5.200 euro.**

Viti 2020 - 2021: D. dhe D.D., (paguar nga kursimet familjare, nga të ardhurat nga pagat për periudhën 2019 - 2021). **Shuma e shpenzuar: 6.700 euro.**

- Institucionin arsimor Albanian College, studimet në kurrikula shqiptar:

Viti 2021 - 2022: D. dhe D.D., (paguar nga kursimet familjare, nga të ardhurat nga pagat, për periudhën 2019 - 2021). **Shuma e shpenzuar: 3.000 euro.**

Për vitin 2022 - 2023: Detyrimi për arsimin e fëmijëve është **3.000 euro**, sipas vërtetimit nr. 601 prot., datë 27.4.2023 të Albanian College. (i pa paguar deri në dorëzimin e formularit).

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim nga Albanian College Tirana, me nr. *** prot, datë 27.4.2023**, ku vërtetohet se:
 - Pagesa për shkollimin e D.D. në vitin shkollor 2018 - 2019, likuiduar në shumën 3.000 euro;
 - ♦ Tarifa për shkollimin e D.D. dhe D.D. në vitin shkollor 2019 - 2020, likuiduar në shumën 5.200 euro;
 - ♦ Tarifa për shkollimin e D.D. dhe D.D. në vitin shkollor 2020 - 2021, likuiduar në shumën 6.700 euro;
 - ♦ Tarifa për shkollimin e D.D. dhe D.D. në vitin shkollor 2021 - 2022, likuiduar në shumën 3.000 euro;
 - ♦ Tarifa për shkollimin e D.D. dhe D.D. në vitin shkollor 2022 - 2023, në vlerën e pa likuiduar prej 3.000 euro.

66. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në llogari të Bujar Deliallisi, rezulton debitimi me transfertë i shumës 36.050 lekë, në datë 05.03.2018, me përshkrimin “..*Likuidim kësti kopshti, D. Deliallisi.*..“

67. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se paraqet dokumentacion vërtetues lidhur me deklarimin dhe burimin financiar të shumave të shpenzuara.

68. Me emalin e datës 12.07.2024, subjekti i është përgjigjur pyetjeve të relatorit ku ka shpjeguar se shuma prej 3.000 euro për shlyerjen e tarifës së studimit të D.D dhe D. D. është paguar nga të ardhurat familjare.

Bashkëlidhur deklarimeve subjekti ka paraqitur material shtesë:

- **Deklaratë noteriale nr. *** rep. , nr. *** kol., datë 4.12.2023**, ku E. Deliallisi deklaron se për të ndihmuar vëllain Bujar Deliallisi, ka kryer pagesën prej 3.000 euro për arsimimin e nipit të saj, D.D., në vitin shkollor 2018 - 2019, me burim financiar nga kursimet e saj ndër vite.
- **Vërtetim mbi bazën e vlerësuar nga ISSH nr. *** prot., datë 6.12.2023**, ku rezulton se për E. Deliallisi janë paguar kontributet mbi bazën e pagës bruto për periudhën qershor 2012 - shtator 2023, nga të cilat, paga mbi të cilën është derdhur kontributi për periudhën maj 2012 - dhjetor 2019, rezulton me vlerë totale rreth 2.080.000 lekë.
- **Statement bankar nga BKT**, ku rezulton se në llogari të E. Deliallisi janë kredituar të ardhurat nga paga në shumën totale rreth 2.450.000 lekë për periudhën shkurt 2008 - maj 2019, nga të cilat, tërhequr cash shuma 127.000 lekë, në datën 09.05.2018; tërhequr cash shuma 120.000 lekë, në datën 03.12.2018 dhe tërhequr cash shuma 120.000 lekë, në datën 18.04.2019.
- **Deklaratë noteriale nr. *** rep. , nr. *** kol., datë 4.12.2023**, ku E. Xh. deklaron se për të ndihmuar motrën e tij Oneda Deliallisi, ka kryer pagesën prej 5.200 euro për arsimimin e nipërve të tij D.D. dhe D.D., në vitin shkollor 2019 - 2020, me burim financiar nga kursimet e tij familjare.
- **Formular i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për personin fizik E. Xh. me NIPT L 72303504Q, për periudhat 2018 - 2021**, ku rezulton se për periudhën 2018 - 2020, ka realizuar të ardhura në shumën totale rreth 4.292.000 lekë, nga të cilat, fitimi në shumën totale rreth 1.272.000 lekë.

69. Konkluzione:

- ✓ Shpenzimet e kryera, për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës deri në datën 28.04.2023, rezultojnë në total rreth 17.900 euro, e konvertuar rreth 1.989.050 lekë, nga të cilat, 8.200 Euro, sipas deklarimit janë me kontribut të familjareve të tij (motrës së subjektit dhe vëllait të bashkëshortes).

- ✓ Nga dokumentacioni i administruar dhe hetimi i Trupës së Vlerësimit rezulton se motrës së subjektit dhe vëllait të bashkëshortes kanë patur mundësi financiare për të kontribuar për nipat e tyre,

DEKLARIMI 1 BASHKËSHORTES - ONEDA DELIALLISI

DEKLARIMI 1 PASURIVE

- ✚ Bashkëpronare në pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 18.10 m², e ndodhur në lagjen nr. 13, Durrës. Përfitur nga privatizimi së bashku me familjen e origjinës. Zotëron 25%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ◆ **Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***,** lëshuar në datën 04.04.2018, për pasurinë nr. ***, Vol ***, faqe ***, zk. ***, e llojit apartament, me sipërfaqe 18.10 m², me adresë: Lagjja nr. *** Plazh, Durrës, regjistruar në bashkëpronësi të B, Xhango, E, Xh., N. Xh. dhe O.D., me pjesë takuese 1/4 secili.
- ◆ **Kartela e pasurisë nr. ***, VOI. ***,** faqe ***, zk. ***, e llojit apartament, me sipërfaqe 18.10 m², me adresë: Lagjja nr. 13 Plazh, Durrës, e regjistruar në bashkëpronësi të B, Xhango, E, Xhango, N, Xhango dhe Oneda Deliallisi.

70. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **ASHK (online) konfirmon pasurinë** nr. 46/259+1-5, VOI. 99, faqe 153, zk. 8518, e ndodhur në Durrës, në bashkëpronësi të B. H. Xhango, N. M. Xhango, E. B. Xh. dhe Oneda Bilbil Deliallisi, me status “aktive” dhe përshkrim “*kërkesë nr. 194480, datë 26.3.2018..., përditësim dhe leje transaksioni me afat 30 ditor..*”.

71. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar se pasuria e deklaruar nga bashkëshortja, me pjesë takuese 1/4, është përfitur me privatizim nga familja e saj, për të cilën për shkak të kohës së largët nuk disponon dokumentacion vërtetues.

72. Në proces-verbalin e datës 15.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti ka sqaruar se paraqet praktikën e privatizimit të apartamentit me sipërfaqe 18.1 m² duke saktësuar se shuma për shlyerjen e kontratës, në dijeninë e tij, është likuiduar nga familjarët e bashkëshortes.

Bashkëlidhur deklarimeve subjekti ka paraqitur material shtesë:

- **Kontratë shitje me rezervë nr. ** rep., nr. ** kol.,** datë 25.01.2016, me blerës B. Xh., N. Xh., E. Xh. dhe Oneda Xhango, me shitës Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Durrës, për blerjen e ambientit të banimit në bashkëpronësi të pandarë me sipërfaqe 18.1 m², me nr. pasurie ***+15, VOI. **, faqe 153, zk. **. Vlera 103.343

lekë, nga të cilat, shuma 3.975 lekë e paguar sipas mandat arkëtimit datë 08.01.2016 dhe diferenca prej 99.368 lekë për t'u paguar për një periudhë 1.5 vjeçare, sipas 20 kësteve me vlerë 5.056 lekë secili.

- **Kontratë qiraje datë 26.12.2011**, me qiramarrës E. B. Xhango dhe qiradhënës Ndërmarrja Komunale Plazh (Bashkia Durrës), për marrjen me qira të ambientit të banimit “kabina nr. 326, Iliria”, për periudhën 26.12.2011 - 25.12.2012, me vlerë 315 + 95 lekë.

73. Konkluzion:

Apartamenti me sipërfaqe 18.10 m², me adresë: Lagjja nr. 13 Plazh, Durrës, në pronësi të bashkëshortes së subjektit dhe familjarëve të saj me pjesë takuese 1/4 secili është përfituar sipas kontratës së lidhur me Entin Kombëtar të Banesave, Durrës, në datën 25.01.2016, me vlerë 103.343 lekë.

- *Pjesa tjetër e pasurive të paluajtshme është e njëjtë me deklarin e bashkëshortit. Bujar Deliallisi e cila është trajtuar më lart.*

- 🚧 Llogari rrjedhëse për pagën, në ABI Bank, me gjendje në datën e deklaramit 0 lekë.
Pjesa takuese: 100%

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim nga ABI Bank nr. ***, prot., datë 24.04.2023**, ku vërtetohet se Oneda Deliallisi është mbajtëse e llogarisë me IBAN nr. 002421409, me balancë 22 lekë.

74. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Banka Amerikane e Investimeve me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në emër të Oneda Deliallisi rezulton llogari page, me balancë -127 lekë, në datë 28.04.2023. Llogaria në ABI Bank është krijuar gjatë periudhës 2020 - 2023.

75. Konkluzion:

- Shtetasja Oneda Deliallisi zotëron llogari page në Bankën Amerikane e Investimeve e cila është krijuar gjatë periudhës 2020 - 2023.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- **Të ardhura neto si Inspektore pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës**, për periudhën qershor 2013 - janar 2014. Shuma: 442.508 lekë.
- **Të ardhura neto nga puna pranë kompanisë “Ferri”, Transforwarding Service**, për periudhën shkurt 2014 - gusht 2015. Shuma: 295.872 lekë.
- **Të ardhura nga trajtimi me leje lindje për fëmijën e parë**, për periudhën qershor 2014 - qershor 2015. Shuma: 375.508 lekë.
- **Të ardhura neto nga pagesa e papunësisë**, për periudhën shtator 2015 - qershor 2016. Shuma: 84.149 lekë.

- **Të ardhura nga trajtimi me leje lindje** për fëmijën e dytë, për periudhën qershor 2016 -qershor 2017. Shuma: 157.457 lekë.
- **Të ardhura nga puna si specialiste buxheti** fillimisht dhe në vijim specialiste auditi, pranë Bashkisë Durrës, për periudhën gusht 2020 - shkurt 2023. Shuma: 2.019.819 lekë.
- **Bashkëlidhur deklaratës:**
- **Librezë pune për shtetasen Oneda Xhango**, ku vërtetohet punësimi pranë DRT Durrës për periudhën 26.04.2013 - 01.02.2014; punësimi pranë “Ferri” Transforwarding Service, për periudhën 01.02.2014 - 03.06.2014; përfitim leje lindje për periudhën 04.06.2014 - 03.06.2015; punësimi pranë “Ferri” Transforwarding Service për periudhën 04.06.2015 - 31.08.2015; përfitim pagesa papunësie për periudhën 01.09.2015 - 25.06.2016; përfitim leje lindje për periudhën 25.06.2016 - 23.06.2017; punësimi pranë Bashkisë Durrës prej datës 19.08.2020.
- **Vërtetim nga DRT Durrës nr. *** prot., datë 16.04.2018**, ku vërtetohet se për periudhën qershor 2013 - janar 2014, Oneda Xhango ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 442.508 lekë.
- **Vërtetim nga Ferri Transforwarding Service** datë 12.04.2023, ku vërtetohet se Oneda Xhango ka përfituar pagë neto: me vlerë 60.000 lekë për periudhën shkurt - maj 2014; me vlerë 16.800 lekë për muajin qershor 2015; dhe me vlerë 19.536 lekë për periudhën korrik - gusht 2015.
- **Vërtetim nga ISSH nr. *** prot., datë 18.04.2018**, ku vërtetohet se Oneda Xhango është trajtuar me leje lindje për periudhën 03.06.2014 - 05.06.2015, për fëmijën e parë në shumën totale 375.508 lekë si dhe për periudhën 25.06.2016 - 23.06.2017, për fëmijën e dytë në shumën totale 157.457 lekë.
- **Vërtetim nga Drejtoria e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Durrës**, nr. *** prot., datë 19.04.2018, ku vërtetohet se Oneda Deliallisi ka përfituar pagesë papunësie për periudhën 01.09.2015 - 25.06.2016, në shumën totale 84.149 lekë.
- **Vërtetim nga Bashkia Durrës me nr. *** prot., datë 14.5.2023**, ku vërtetohet se Oneda Deliallisi është punonjëse me detyrë Specialist, pranë Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto, për periudhën 19.08.2020 - 31.03.2023, në shumën totale 2.019.819 lekë.
- **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023** konfirmon se në llogari të Oneda Deliallisi rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe leje lindje në shumën totale rreth 1.132.000 lekë, për periudhën 01.07.2013 - 01.09.2015.
- **Banka Amerikane e Investimeve me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023**, konfirmon se në llogari të Oneda Deliallisi rezulton kreditimi i të ardhurave nga Bashkia Durrës në shumën totale rreth 1.973.786 lekë, për periudhën 02.09.2020 - 02.03.2023 si dhe kreditimi i shumës 100.000 lekë në datë 13.04.2021, me përshkrim “Grant rindërtimi, Bashkia Durrës”.
- **Credins Bank me shkresën nr. ***prot., datë 22.09.2023**, konfirmon se në emër të Oneda Deliallisi rezulton llogari page, e mbyllur në datën 18.12.2017. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga Drejtoria Rajonale e Punësimit, në shumën totale rreth 84.149 lekë për periudhën 03.12.2015 - 08.07.2016.

- **Akt martese nr. ***, datë 24.6.2014**, me datë shpalljeje 13.05.2014 (nr. 71), me bashkëshorte Oneda Xhango dhe bashkëshorti Bujar Deliallisi me adresë: Rruga, '***', ***, Durrës.

76. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **ISSH me shkresën nr. nr. *** prot., datë 11.08.2023**, konfirmon se për Oneda Deliallisi janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto: nga subjekti “Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës” për periudhën janar 2012 - janar 2014; nga subjekti “Ferri Transforwarding Service” për periudhën shkurt 2014 - gusht 2015; dhe nga subjekti “Bashkia Durrës për periudhën gusht 2020 - qershor 2023”.
- **ISSH me shkresën nr. ***prot., datë 11.08.2023**, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
- **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ***, datë 17.08.2023**, sqaron se për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, n.q.s. nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna.

77. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka konfirmuar shumën e përfituar si grant rindërtimi nga dëmet e tërmetit e cila nuk është konsideruar e ardhur dhe për këtë arsye nuk është evidentuar në formular. Subjekti ka dhënë shpjegime edhe lidhur me transaksionet e konfirmuara nga ABI Bank, ku të ardhurat e bashkëshortes nga paga, leje lindje dhe pagesat, për periudhën korrik 2013 - prill 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 3.495.000 lekë.

78. AK Invest, me shkresën nr. * prot., datë 18.8.2023**, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur nuk janë klientë dhe sipas përgjigjes së Money Gram Internacional nuk kanë kryer transaksione për transfertat monetare. Gjithashtu, nga kërkimi i detajuar i transaksioneve, rezulton një shtetas me emrin Bujar Deliallisi / Deliadhisi për të cilin nuk disponohen të dhëna për të vërtetuar gjeneralitetet, i cili ka kryer 4 transfertat monetare si përfitues dhe konkretisht:

- *Tërheqje nga Money Gram i shumës 400 USD, në datën 29.12.2010, dërguar nga SHBA.*
- *Tërheqje nga Money Gram i shumës 100 USD, në datën 22.4.2011, dërguar nga K. Deliallisi (nga SHBA).*
- *Tërheqje nga Money Gram i shumës 250 USD, në datën 30.8.2011, dërguar nga M. Deliallisi (nga SHBA).*
- *Tërheqje nga Money Gram i shumës 350 USD, në datën 20.4.2012, dërguar nga K. Deliallisi (nga SHBA).*

79. Në proces-verbalin e datës 06.12.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti nuk ka konfirmuar sa më sipër duke sqaruar se nuk ka kryer transaksione me shtetasit e cituar nga AK Invest.

80. Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- Nga verifikimet në sistemin e gjendjes civile NCR, rezulton Bujar Deliallisi i cituar nga AK Invest ka atësi të ndryshme nga subjekti i vlerësimit, ku konkretisht rezulton shtetasi B. Mas-har D. i datëlindjes 04.02.1970.

81. Konkluzion:

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 28.04.2023, është deklaruar bruto 1.329.103 lekë + 95.000 Euro + 70 USD e konvertuar në rreth 11.893.000 lekë dhe neto rreth 9.670.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit, për periudhën mars 2003 - prill 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 15.430.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes, për periudhën korrik 2013 - prill 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 3.495.000 lekë.
- ✓ Për periudhën mars 2000 - prill 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum personal (deri në qershor 2013) dhe për konsum familjar së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët (prej muajit korrik 2013 dhe në vijim), në total rreth 9.882.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar nga subjekti:

- Kontribut financiar nga familjarët, për blerje apartamenti. Shuma totale 3.885.593 lekë + 53.080 USD, e konvertuar rreth 9.253.000 lekë.
- Huamarrje për blerje apartamenti, në shumën 20.000 euro. Shuma e detyrimit financiar, e konvertuar rreth 2.222.400 lekë.
- Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total rreth 250.000 lekë.
- Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë deklaruar shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur, në total 1.000 euro e konvertuar rreth 111.000 lekë.
- Për periudhën deri në datën 28.4.2023, janë shpenzuar për arsimimin e fëmijëve, në total rreth 17.900 euro e konvertuar rreth 1.989.000 lekë
- Kontribut financiar nga familjarët për pagesën e tarifave për shkollimin e fëmijëve për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe për vitin shkollor 2019 - 2020. Shuma totale 3.000 euro + 5.200 euro, e konvertuar rreth 911.000 lekë.

C. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë

kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **z. Bujar Deliallisi** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtorja e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 18.07.2023 raportin e kontrollit të figurës³ ku ka konstatuar se:

- ✓ **Subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi, me detyrë Zëvendësdrejtor në “Drejtorinë Vendore të Policisë, Durrës”, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.

³ Raport për kontrollin e figurës

- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

Në mbështetje të neneve 35-42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim përgjigjet e institucioneve ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

82. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën “I kufizuar”, nr. *** prot., datë 07.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

- a. Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve
- b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)

83. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën “I kufizuar”, nr. *** prot., datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

- a. Nuk rezulton i dënuar

84. Institucion Ligjzbatues me shkresën “Sekret”, nr. *** prot., datë 25.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

a. Disponon të dhëna.

85. Institucion Ligjzbatues me shkresën “I kufizuar”, nr. *** prot., datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare nuk kanë:

- a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (*sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016, “për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj.;
- c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.*);
- d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
- f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- g. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO.
- i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore

86. Institucion Ligjbatues, me shkresën “Konfidencial”, nr. *** prot., datë 11.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

a. Nuk disponon të dhëna.

87. Institucion Ligjbatues, me shkresë “sekret”, e datës 07.08.2023, shkresën “sekret”, nr. *** prot., datë 19.06.2023, dhe shkresën “sekret”, nr. *** prot, datë 03.10.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:

a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;

b. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka reregjistruar procedimin penal nr.***, viti 2003 për veprën penale "Mos marrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme", parashikuar nga neni 251 i Kodit Penal. Në përfundim të veprimeve hetimore është marrë vendim për pushimin e hetimeve.

c. Pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është referuar materiali procedural i datës 26.06.2007 në ngarkim të Bujar Deliallisi, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "*Plagosje e lehtë me dashje*", parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, me detyrë Specialist i Policisë Kriminale, në Komisaratin e Policisë Port Durrës. Në përfundim të veprimeve hetimore është marrë vendim për pushimin e hetimeve.

d. Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka regjistruar procedimi penal nr.***, datë 17.12.2015, iniciuar me kallëzimin e një shtetasi, me të cilin kërkohet ndjekja penale për punonjësin e policisë Bujar Deliallisi për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*" parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe "*Dëmtime të tjera me dashje*" parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal. Shtetasi pretendon se, është keqtrajtuar dhe fyer nga ky punonjës policie. Në përfundim të veprimeve hetimore është marrë vendim për pushimin e hetimeve datë 10.03.2016.

88. Institucion Ligjbatues, me shkresën “i kufizuar”, nr. ***. prot, datë 31.10.2023 për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;

b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;

c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;

d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;

e. Nuk ka pasur raste të urdhrit ndërkombëtar të ndalimit;

f. Prokuroria Pranë Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me shkresën nr. ***, datë 13.09.2023, bën me dije se:

- Ka regjistruar procedimin penal nr.***, datë 06.03.2006, në ngarkim të shtetasisit Bujar M. Deliallisi, i datëlindjes 29.04.1976, për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, e cila është dërguar me datë 08.03.2006, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

g. Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me

shkresën nr.*** datë 19.09.2023, bën me dije se, nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 1990 - 2023 rezultoi të jenë regjistruar materialet si me poshtë:

- Kallëzimi penal nr. *** viti 2003 për veprën penale të "Kanosjes" parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, marrë vendim për mos fillim të procedimit penal me datë 23.04.2004.
- Kallëzimi penal nr. *** viti 2016, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" dhe "Korrupsioni pasiv" parashikuar nga neni 248 dhe 259 Kodit Penal, marrë vendim për pushimin e procedimit penal me datë 09.11.2016.

89. Institucion Ligjbatues, me shkresën "i kufizuar", nr. **** prot., 02.08.2023, bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi :

- a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.
- b. Nuk është marre ne cilësinë e te pandehurit apo personit nen hetim sipas përcaktimeve te nenit 34 dhe 35 te Kodit te Procedurës Penale;

90. Institucion Ligjbatues, me shkresën "sekret", nr. **** prot., datë 25.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Bujar Deliallisi dhe personat e lidhur me të:

- Rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi dhe personin e lidhur Orned Deliallisi.
- Nuk rezultuan raportime për personat lidhur D. Deliallisi dhe D. Deliallisi.

91. Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar, me shkresën "i kufizuar", nr. ****prot., datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit "Konfidencial" lëshuar me datë 03.06.2021, të vlefshme deri në datën 02.06.2026.
- b. AKSIK me shkresë nr. *** datë 06.11.2019 ka njoftuar Ministrin e Brendshëm dhe AMP-në për refuzimin e CSP.
- c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

92. Avokati i Popullit me shkresën "e paklasifikuar", me nr. *** prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

93. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën "I kufizuar", nr. *** prot., datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

94. Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi nuk është disponuar asnjë ankesë nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

95. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, me nr. ***, datë 31.05.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” konkludohet se subjekti vlerësimit z. **Bujar Deliallisi**:

✓ **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**


Në përfundim të hetimit të kryer:

96. Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit z. Bujar Deliallisi, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi:

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONAL

 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit **z. Bujar Deliallisi** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin **Zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore Policisë, Durrës**. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Zëvendës drejtor i Drejtorisë Vendore Policisë, Durrës.

- ✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHTETIT.

Struktura e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. *** datë 01.09.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

- ✚ **Punonjësi i Policisë z. Bujar Deliallisi është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:

- ✚ Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. *** ;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. ***;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.

- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.
- ✚ Punonjësi i Policisë, Komisar Bujar Deliallisi është emëruar në detyrë Zëvendësdyrejtor i Drejtorisë Vendore Policisë, Durrës me urdhrin nr.*** datë 27.03.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✚ Në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Bujar Deliallisi bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

97. Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsim i Lartë	Akademia e Policisë	1995	1999	Tiranë	Diplomë
Arsim i Lartë	Fakulteti i Drejtësisë	1997	2022	Tiranë	Diplomë

- Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomat.
- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.
- ✓ **Trupa e Vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, konstaton se subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.**
- ✓ **Në kuptim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit.**
- ✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi trajnimet dhe kualifikimet e subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

98. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

- ✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur,

konstatohet se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar subjekti i vlerësimit:

- I. **ka realizuar trajnime,**
- II. **nuk ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.**

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë relativisht të hershme për harkun kohor të viteve 2010-20153. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018-2023)

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës së vlerësimit subjekti nuk gëzon certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.**

99. Vlerësimet e punës:

Gjatë zhvillimit të hetimit mbi procesin e vlerësimit të aftësive profesionale trupa e vlerësimit ka konstatuar se:

- Për periudhën e vlerësimit (2018-2022) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, subjekti ka 3 (tre) vlerësime pune, me rezultat “**shumë mirë**”, konkretisht për vitin 2018, 2021 dhe 2022.
- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se për vitin 2019 dhe 2020, eprorët e subjektit nuk kanë plotësuar vlerësime pune, sipas raportimeve të vetë institucionit.**

100. Masat disiplinore

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

- ✓ **Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.**

101. Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklaratimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Bujar Deliallisi ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej **23 vitesh e 9 muaj**. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban.

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. urdhri	Data	
			Nga	Deri
N/komisar	Ngritur në gradë	Nr.***, datë 18.06.2008	11.06.2008	27.05.2019
Komisar	Ngritur në gradë	Nr.***, datë 27.05.2019	01.06.2019	30.06.2024
Kryekomisar	Ngritur në gradë	Nr.***, datë 01.07.2024	01.07.2024	vazhdim

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
01.06.2019	23.04.2020	DVP Gjirokastrë	Shef Seksioni i Analizës së Informacionit Kriminal
24.04.2020	19.09.2021	DVP Shkodër	Shef Seksioni në Sektorin e Komandës dhe Kontrollit
20.09.2021	16.11.2022	DVP Durrës	Shef Seksioni për hetimin e krimit ekonomiko-financiar
17.11.2022	26.03.2023	DVP Korçë	Shef në Sektorin për hetimin e trafiqeve dhe narkotikeve
27.03.2023	vazhdim	DVP Durrës	Zëvendës drejtor për hetimin e krimeve

Policia e Shtetit konkludon se:

- Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Zëvendës drejtor**”, në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon. Funksionet dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në

përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve në nënligjore.

102. Konkluzione:

- ✖ Nga të dhënat venë në dispozicion nga Policia e Shtetit, konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “Zëvendësdrejtor”, jo në përputhje gradën që disponon.
- ✓ Trupa e vlerësimit në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit z. Bujar Deliallisi, arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, me përjashtim të funksionit të fundit që mban dhe është subjekt i vlerësimit kalimtar, pasi nuk përputhet raporti funksion - gradë.
- ✓ **Me emalin e datës 12.07.2024, pyetjeve së dërguar nga Relatori i çështjes, subjekti ka sqaruar se me Urdhër nr. ***, datë 01.07.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i është dhënë grada “Kryekomisar”.**

103. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

- ✓ Trupa e vlerësimit konstaton se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës 5-vjecare të vlerësimit, ka marrë pjesë në konferenca/ workshope/ seminare.

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin:

Subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLUZION PËRFUNDIMTARE

Trupa Vlerësuese e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet

nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Bujar Deliallisi në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi referuar nenit 59, germa “ç”, të si dhe nenit 62 germa “ç”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I

1. Konfirmimin në detyrë e subjektit të vlerësimit, **z. Bujar Deliallisi**.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **29.08.2024**.

KRYESUES

EDONA DUSHAJ

RELATOR

ENTON RADOVANI

ANËTAR

KLEADA MERSINLLARI